


MINISTRIA FINANCEVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANES KAPSHTICE



LËNDA: Kërkesë për shpallje publike

DREJTUAR: DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI I ANALIZAVE DHE APOSTERIORIT
SEKTORI I MONITORIMIT TË BORXHIT / TIRANE

DREJTUAR: DREJTORIA E BURIMEVE MBËSHTETËSE

Adresa: Korçë, Kashar Mëzez, Lagjia Fushë Mëzez, autostrada Korçë-Durrës, km 1,
Qendra "Pajtoni Bussines Center", kati 5.

Bazuar në nenin 96 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe pikës 4 të nenit 162 të Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë", 4. "...organi publik publikon aktin në faqen e tij të internetit dhe ..." kërkojmë shpalljen publike për vendimin për shpallje debitor, për ;

Subjekti: "GS SEASONS FRUAS" me NIPT L94805001Q

Vendimi: Nr 228 date 04/11/2025

Detyrimi: 449.415 leke detyrime, 50.000 leke penalitete si edhe kamate vonesat që aplikohen mbi detyrimin.

Kërkesa paraqitet mbështetur në faktin se subjekti nuk është njoftuar në adresën e deklaruar ndaj, lutemi që për vazhdimin e procedurave ligjore, me tej pasi për rikuperimin e borxhit doganor, është domosdoshmëri shpallja publike dhe data e shpalljes publike (bashkëlidhur vendimi Nr 228 date 04/11/2025).

Ju falenderojmë për bashkëpunimin.

KRYETARI I DEGES SE DOGANES KAPSHTICE

DRITAN ÇEKANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS KAPSHTICE

2577/

4.11.2025

Nr 2548/2
prot

Date 4/11/2025

VENDIM
Nr 228 date 4.11.2025

Ne cilesine e Kryetarit te Deges Doganore Kapshtice dhe njekoheisht te vendimarresit shqyrtova proces verbalin e konstatimit me Nr 2547 Prot, date 28/08/2025 te Zyres se Mbikqyrjes Doganore Kapshtice per kontrollin e e Rregjimit te Lejimit te Perkohshem Nr P20240827/34517/1 mbajtes i te cilit eshte subjekti "GS Seasons Fruas" me NIPT L94805001Q, adrese Korçe-Erseke, Km8, Nr.P 116, Mollaj, perfaqesues/deklarues agjensia doganore Spedalb-AD/J038 Kapshtice.

KONSTATOVA SE:

Proces verbali i konstatimit me Nr 2547 Prot, date 28/08/2025 te Zyres se Mbikqyrjes Doganore Kapshtice per kontrollin e e Rregjimit te Lejimit te Perkohshem Nr P20240827/34517/1 mbajtes I te silit eshte subjekti "GS Seasons Fruas" me NIPT L94805001Q, adrese Korçe-Erseke, Km8, Nr.P 116, Mollaj, perfaqesues/deklarues agjensia doganore Spedalb-AD/J038 Kapshtice pra, eshte mbajtur per proceduren e verifikimit dhe per kontrollin e rregjimit te sipercituar.

Rezulton se subjekti "GS Seasons Fruits" me NIPT L94805001Q, referuar aplikimit DPD-202400034517 date 23.08.2024, eshte paisur nga Dega e Doganes Kapshtice, me Autorizim per Perdorimin e Rregjimit te Lejimit te Perkohshem me Nr.P20240827/34517/1.

Autorizimi i i Rregjimit te Lejimit te Perkohshem, identifikohet nga te dhenat e meposhteme: Periudha kohore e vlefshmerise se autorizimit: 27.08.2024-26.02.2025 - 6 Muaj; mallrat qe do te vendosen ne regiimin doganor: "Kosha plastik ambalazhi (Binsa)"; Kodi tarifor: *3923*, sasia : 1,500 cope, vlere: 15,000 euro; periudha kohore e shkarkimit/rieksportit: 6 Muaj.

Nga verifikimi i menyres se funksionimit te Rregjimit te Lejimit te Perkohshem te mesiperm, ne perfundim edhe te afatit te shkarkimit, struktura kompetente, Zyra e Mbikqyrjes Doganore, evidentojne dhe konstatojne se subjekti, ka kryer proceduren e transferimit me deklaraten doganore IM5 R 16827, date 30.08.2024 te artikullit "Kosha plastike 280 cope", sipas bilancit te autorizimeve dhe procedurave te zgjeruara si me poshte: me deklarate doganore Im5, R16827 date 30.08.2024 (5353 transferim nga P20231212/27558): Kosha plastike (Binsa), sasia =280 cope, peshe 10,032 kg vlere= 1,440 euro dhe ka eksportuar : 0 (zero).

Nga kontrolli ne sistemin Asycuda dhe e dosjes me dokumentacionin fizik te subjektit perfutues i ketij autorizimi, u konstatua se ne mbarim te afatit te autorizimit (26.02.2025) perfshire dhe periudhen kohore te shkarkimit/rieksportit (6 muaj), subjekti nuk i ka dhene destinacion doganor mallrave te importuara ne RLP dhe nuk ka depozituar ne degen doganore kerkesen per shtyrjen e afatit te rieksportit.

Ne referim te ligjit Nr. 102/2014, date 31.07.2014 "Kodi Doganor ne Republiken e Shqiperise", vleresohet se:

- Autorizimi i Regjimit te Lejimit te perkoheshem me perjashtim te plote P20240827/34517/1 nuk ka funksionuar ne menyre korrekte;
- Mosdhenia e destinacionit te mallrave ne perfundim te autorizimit, bie ndesh me dipozitat e parashikuara ne ligjin Nr. 102/2014, date 31.07.2014 "Kodi Doganor ne Republiken e Shqiperise" nenet 191 deri 202, 223 deri 226, VKM Nr.651 date 10.11.2017 "Dispozitat Zbatuese te Kodit Doganor", nenet 533 deri 534, 649 deri 685;
- Në mbarimin e vlefshmerisë së autorizimit, bazuar në nenin, 250-1 -a, 252-c dhe 257-1-a, të ligjit Nr. 102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë i ndryshuar, i lindin detyrime doganore dhe njekohesht penalitete.

D) -Neni 250, pika 4, rezulton te kete parashikuar se "pagesa e giobës që zbatohet për shkeljen doganore në asnjë rast, nuk është shkak për te përjashtuar shkelësin nga pagimi i detyrimeve të

importit ose eksportit që duhen paguar për mallrat, objekt i shkeljes”, te cilat ne rastin ne shqyrtim jane ne vleren 449.415(katerqind e dyzet e nente mije e katerqind e pesembedhjete) leke.

-Detyrimi doganor i evidentuar buron nga fakti se, mallrat objekt i Rregjimit te Lejimit te Perkohshem, jane mallra te cilat jane futur ne territorin doganor shqiptar, pa ju nenshtuar pageses se detyrimeve doganore (pasi ligji i posacem, e parashikon si te drejte te subjektit), por nuk i akordon te drejten subjektit te moskryeje veprimet per dhenie destinacioni doganor mallrave, madje ligji percakton detyrimin per dhenie destinacion, percakton afate kohore, si edhe efekte ligjore ne rast te mospermbushjes se detyrimeve te percaktuara.

-Mosdhenia e destinacionit doganor per mallrat objekt autorizimi, cenon interesat financiare te autoritetit doganor, per vleren koresponduese, qe do te duhet te paguheshin per keto mallra, nese ne daten e deklarimit do ti nenshtroheshin pageses se detyrimeve doganore.

II) Referuar penalitetit per tu aplikuar vleresohet se ne referim te ligjit Nr. 102/2014 date 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikes se Shqiperise", neni 28, pika 1) parashikon se "Personi ndaj te cilit eshte dhene vendimi duhet te permbushet detyrimet qe rjedhin nga ky vendim.

Neni 252 pika c, parashikon se "Mosrespektimi nga personi ndaj te cilit eshte dhene vendimi ne lidhje me zbatimin e legjisllacionit doganor i detyrimeve qe rjedhin nga ky vendim ne perputhje me piken 1, te nenit 28 perben kundervajtje administrative dhe duhet te ndeshkohet si e tille".

Vleresohet se ne rastin ne shqyrtim, persa evidentohet me siper, Rregjimi i Lejimit te Perkohshem nuk ka funksionuar ne menyre korekte dhe subjekti ne perfundim te afatit, nuk u ka dhene destinacion doganor mallrave.

III) Referuar mases se penalitetit. Neni 257/1/a parashikon se a) kur kundervajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, lloj) dhe sjell diferencë në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën 2-fish të detyrimit të munguar; b) kur kundervajtja nuk ka të bëjë me mallrat, sipas përcaktimeve të shkronjës "a", zbatohet sanksion në masën 50 000 lekë deri në 500 000 lekë. Dispozita e sipercituar parashikon dhe perdor termin "ndryshime ne sasi" te cilat i referohen ndryshimit ndermjet sasise se autorizuar/deklaruar me sasine e konstatuar nga autoriteti doganor ne rast te verifikimeve apo kontroleve, pra ne sasi qe do te perfaqesonte nje perqindje konkrete diference te mallrave. Ndaj mbeshtetur ne parimet e parashikuara ne ligjin 55/2014 "Kodi i Procedurave Administrative", procedures vendimarese administrative, mjeteve te ankimit e rishikimit, ne referim te ligjit Nr. 102/2014 date 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikes se Shqiperise", neni 28, pika 1), neni 252/c, neni 257/a, neni 280 e vijues .

VENDOSA

- 1) Subjekti "GS Seasons Fruas" me NIPT L94805001Q, adrese Korçe-Erseke, Km8, Nr.P 116, Mollaj, perfaqesues/deklarues agjensia doganore Spedalb-AD/J038 Kapshtice, te detyrohet te paguaje detyrimet doganore, qe u korespondojne ketyre mallrave dhe te perlllogaritura ne vleren 449.415(katerqind e dyzet e nente mije e katerqind e pesembedhjete) leke.
- 2) Subjekti "GS Seasons Fruas" me NIPT L94805001Q, adrese Korçe-Erseke, Km 8, Nr.P 116, Mollaj, perfaqesues/deklarues agjensia doganore Spedalb-AD/J038 Kapshtice, te ndeshkohet me penalitet ne vleren 50.000(pesedhjete mije) leke.
- 3) Nje koje e vendimit i kaloje Zyres se Finances per kontabilizim te vendimit dhe kopje Zyres se Mbikqyrjes Doganore per ndjekje dhe verifikim te sasise dhe veprimeve te subjektit.
- 4) Kunder ketij vendimi mund te ushtrohet ankim para Drejtorit te Pergjithshem te Doganave, ne afatin 30 ditor nga marja dijani per vendimin, duke plotesuar kushtin e pageses se detyrimeve doganore te percaktuara me siper dhe garantimit te penalitetit te aplikuar, ne mbeshtetje te nenit 280 e vijues te ligjit 10/2014 date 31/07/2014 "Kodi Doganor i Republikes se Shqiperise".

KRYETARI I DEGES SE DOGANES KAPSHTICE

DRITAN ÇEKANI

